

Hollywood-i në vitet e '20-ta të shekullit XX. Sistemi i produksionit të studiove. Slapstick komedia.

Deri në fund të LPB, industria filmike amerikane kishte krijuar strukturën e vet, të cilën do ta mbante gjatë dyzet vjetëve të ardhshme. Producentët e pavarur kishin ngadhënjyer ndaj MPPC (siç ishte Adolf Zukor, William Fox dhe Karl Laemle), e cila kishte monopolin në kinematografinë amerikane, për t' u shndërruar pastaj edhe vetë në monopol të integruar vertikal, të cilat drejtonin zinxhirin e sallave të tyre projektuese dhe të distribuimit.

Me avansimin e *filmit të metrazhit të gjatë*, fotografitë e lëvizshme gjithnjë e më tepër tërhiqnin klasën e mesme qytetare, ndërsa sallat ekzotike të shfaqjes të cilat mund të pranonin edhe deri në tre mijë shikues hapeshin gjithnjë në qytete të vogla e të mëdha. Duke iu falënderuar gjatësisë së filmave, dhe inflacionit që dominonte dhe pagave enorme të larta të yjeve, buxhetet e produksioneve u dhjetëfishuan krahasuar me nivelin e tyre në periudhën e mëhershme, ndërsa filmi, për vetëm disa vjet, u bë industria më e rëndësishme e vendit.

Në fillim të viteve të '20-ta, gjigantët e kësaj industrie të njohur si "Treshja e madhe", ishin "Famous Players-Lasky Corporation" e Adolph Zukor-it, e cila në vitin 1916 e mori kompaninë "Paramount Pictures" si njësi të veten për distribuim dhe shfaqje, e që pastaj do të njihet si "Paramount"; "Loew's Incorporated" zinxhiri kombëtar i sallave të kinemave në pronësi të Markus Louis, i cili do të futet edhe në produksion pasi e merr edhe kompaninë "Metro Pictures" në vitin 1920; dhe "First National" (pas 1921 "Associated First National"), kompani e cila në vitin 1917 kishte themeluar 26 sallat e shfaqjeve më të mëdha në vend për t' iu kundërvënë praktikës së deriatëhershme të *blockbooking*¹ duke financuar produksionin e vet.

Një nga shoqëritë më të fuqishme ishte "United Artist" ("Artistët e bashkuar", 1919), ku bënin pjesë Charlie Chaplin, Mery Pickford, David W.Griffith dhe Douglas Fairbanks.

¹Blockbooking ishte një praktikë që i përket shpërndarjes së filmit, e që një teatër (sallë shfaqjeje) ishte e detyruar të blinte një numër filmash së bashku për shfaqje, në vend që të kishte mundësinë të zgjidhte filmat që duan t' i shfaqnin. Themelues i kësaj ideje ishte Adolph Zukor, sipas së cilës një kompani që dëshironte të shfaqte një film të kategorisë A, ishte e detyruar të blinte edhe filma të tjerë të kategorisë B, që siguronte tregun e produksionit, pavarësisht përmbajtjes nganjëherë mediokre të filmave "të imponuar". Kjo praktikë u hoq me ligj nga ShBA, në fillim të viteve 1940 pas ankesës së disa produksioneve.

Artistët u kthyen në perëndi dhe Hollywood-i u bë një fabrikë e ëndrrave, që filloi të ndikonte në të gjithë opinionin botëror. Mijëra emigrantë shkuan drejt Hollywood-it. Vetëm në vitet 1918-1919 mbi 18000 vajza të bukura nga e gjithë bota shkuan në Hollywood me shpresën për t' u bërë "yje". Ky u bë një nga kontigjentet më të mëdha të fitimit për biznesmenët.

Në vitet '20, dolën edhe "yje" të reja: Greta Garbo, Rudolfo Valentino, Marlen Dietrih, Pola Negri, etj., të cilët u bënë idhuj të spektatorëve në të gjithë botën.

Roli i regjisorit që sapo kishte filluar të njihej, u zbeh. Përjashtim bënë disa regjisorë, të shquar të filmit amerikan, si: David W.Griffith, Cecil de Mille, Thomas Ince, Erih von Stroheim, si dhe ata të filmit komik që u bë gjinia më e parapëlqyer, si Mack Sennett e veçanërisht Charlie Chaplin.

Thomas Ince(1882-1924)

Gjatë viteve të njëzeta studiot u shndërruan në fabrika për argëtim masiv komercial, të inspiruar nga shembulli i Thomas Harper Ince (1882-1924) një dekadë më parë.

Sikur edhe Griffith, Ince e filloi karrierën e tij si aktor-regjisor në vitin 1910, themeloi studion e tij Inceville, në kanjonin Santa Ynez, pranë Hollywood-it. Aty Ince bëri regjinë e më shumë se 100 filmave, të gjatësisë nga dy deri në pesë bobina, para se t' i përkushtohej ekskluzivisht vetëm produksionit në vitin 1913. Në mes të viteve 1914-1918 ndërtoi Inceville-in, si studion e parë të njohur të tipit holivudian, me pesë hapësira të veçanta për xhirime.

Mënyra e tij e produksionit u shndërrua në prototip për sistemin e mirorganizuar të studiove, i cili gjatë 40 vjetëve të ardhshme do të dominonte në industrinë filmike amerikane. Mënyra e punës së ThomasInce, nënkuptonte formimin e një numri më të madh të njësiteve të produksionit të cilat veprojnë në hapësirat e tij, secila nga to nën udhëheqjen e një regjisorit. Shkrimtarët që bashkëpunonin ngushtë edhe me Ince, por edhe me regjisorët, do të përgatisnin librat e xhirimit të detajuara (të njohura si *storyboard*) në të cilën do të planifikohej i tërë produksioni, kuadër për kuadër. Ince e miratoi librin e xhirimit dhe filloi xhirimi i filmave në mënyrë strikte sipas orarit të planifikuar. Kur përfundohej xhirimi, Ince mbikëqyrte montazhin duke mbajtur të drejtën për miratimin e versionit të fundit.

Kjo mënyrë e xhirimit të filmave ishte plotësisht e kundërt me modelin e improvizimit të Griffith dhe paraqiste një stuhitë të një të ardhmeje të fortë kapitaliste të filmit amerikan, duke ndihmuar të japë njëkohësisht sqarime se pse Griffith nuk arriti të jetë më gjatë pjesë e kësaj së ardhmeje. Megjithatë, Ince, sikur edhe Griffith, ishte njëfarë gjeniu i vizuelizimit të përmbajtjes së luajtur, prandaj edhe pjesa dërmuese e produksioneve të tij (pjesën më të madhe e përbëjnë uesternët aksionë), kishte tendencë të jenë filma të

metrazhit të gjatë të konstruktuar në mënyrë strikte me tempo të mirë, të cilët mbanin firmën e tij.

Ince dhe Griffith, u bënë partnerë pune për disa vjet me Mack Senett në "Triangle Film Corporation", të cilën e themeloi Harry Aitken, pasi e kishte braktisur Kompaninë Mutual në vitin 1915. Kjo kompani kishte një koncept të shëndoshë të organizimit: secili nga tre regjisorët duhej të ishte mbikëqyrës i prodhimit të filmave të atij lloji që i kishte bërë të njohur:

filmat aksionë dhe uesternë - Ince-i;

komeditë slapstick dybobinëshe – Senett-i;

ndërsa melodramat dhe spektaklin – Griffith.

Praktikisht Triangle dështoi pas tri vjetësh për shkak të vlerësimit të dobtë të shijes së publikut, dhe përpjekjes së gabuar që në film të sillen yjet e teatrit. Kur projekti dështoi, Ince e ndërtoi një studio gjigante për vete në Culver City (e cila dhjetë vjet më vonë do të bëhet pjesë e MGM) dhe aty e vazhdoi produksionin e filmave të metrazhit të gjatë, deri në vitin 1924, kur edhe vdiq.

Gjatë karrierës së tij Thomas Ince, në procesin e krijimit të filmit, solli skenarin e detajuar apo librin e xhirimit, dhe ishte pionier i sistemit të studiove të produksionit. Ai, gjithashtu, i dha mundësinë e parë të merren me film shumë aktorëve dhe regjisorëve të talentuar, si: William S. Hart, Sessue Hayakawa, Henry King, etj. Gjithashtu, ai i dha botës së filmit shumë tituj të metrazhit të gjatë, si: *The Battle of Gettysburg*² (1913), *The Typhoon* (1914), *The Patriot* (1916), etj., pjesa dërmuese e të cilëve, janë model i filmit të luajtur të realizuar shpejt dhe ekonomik. Në lidhje me këtë, John Ford njëherë kishte thënë: "Ince ka pasur ndikim të madh në film, sepse përpiqej t' i shtynte të lëvizin".

Mack Sennett(1880-1960)

Një tjetër arkitekt i sistemit amerikan të studiove, dhe themelues i komedisë së ekranit pa zë, ishte partneri i Ince dhe Griffith në Triangle Film Corporation, Mack Sennett (1880-1960). Senett ishte angazhuar si aktor në shumë filma të Griffith në kohën e kompanisë Biograph, dhe ishte dhënëpas mësimin të metodave regjisoriale. Në vitin 1910, edhe ai filloi të xhironte filma për Biograph, por iu dha shumë pak hapësirë kreative. Në vitin 1912, Senett, themeloi kompaninë Keystone Film Company, në Edendale (California), me përkrahjen financiare të Adam Kessel dhe Charles O. Baumann, pronar i Motion Picture Company nga Nju Jorku, por ndërkohë studion e zhvendosi në Hollywood. Nga viti 1913-1935 në këtë studio prodhoi mijëra filma një dhe dybobinësh dhe qindra filma të metrazhit të gjatë duke krijuar edhe një zhanër të ri filmik, slapstick komedinë pa zë, i cili do të jetë lloji më vital filmik amerikan në vitet e '20-ta. Nën ndikimin e cirkut, varieteve, burleskave, pantomimës, stripit komik dhe filmave me ndjekje të aktorit frances Max Linder, komeditë Keyston të Senettit, paraqisnin një univers surreal dhe

²<http://www.youtube.com/watch?v=nQwQL6Q2kEM>

anarkik ku logjika e rrëfimit dhe karaktereve ishte e varur nga një humor i dhunshëm por i një natyre të parrezikshme. Kjo ishte një botë e frymëzuar nga krimi – botë e gjuajtjes me ëmbëlsira, luhatjeve buzë humnerës, ngasjes me automobilë, dhe mbi të gjitha, ngritjes së gjërave në ajër nga shpërthimet. Efektet komike të arritura nga luhatjet dhe të shtënatnë këta filma vareshin nga montazha e shpejtë dhe “shpëtimi në moment të fundit”, teknika që i mësoi nga Griffith, si dhe nga ndjenja e pabesueshme e vet Senettit për ritmin. Ai ka qenë gjeni për tajmingun (kohën) e lëvizjes, si për aktivitetin e harbuar fizik që i mbushte kuadrat e tij poashtuedhe për ritmine montazhit, të cilat si pa frymë, me një shpejtësi të paparë i shtynin ata kuadra përpara. Filmat e Senett-it shpesh i paradizonin edhe filmat konvencionalë të autorëve të tjerë, veçanërisht të Griffith-it (Teddy and the Throttle, 1916), apo paraqisnin satirë për Amerikën e atëhershme që i adhuronte makinat (Wife and Auto Trouble, 1916).

Në dy vitet e para të Keyston, Senett-i, vet e bëri regjinë e shumicës së filmave të tij, ndërsa nga viti 1914 e mori modelin e Insvil-it dhe filloi të punonte ekskluzivisht si shef i prodhimit i cili bashkëpunon ngushtë me regjisorët, aktorët dhe skenaristët e tij. Megjithatë, për dallim nga Ince, Senett-i më shumë i pëlqente idetë e thjeshta për rrëfime në vend të librave të detajuara të xhirimit, ashtu që në filmat e tij gjithmonë lente hapësirë për improvizime. Është i admirueshëm numri i madh i yjeve të komedisë dhe regjisorëve të cilët karrierën e tyre e kanë filluar në Keystone. Senetti prodhoi filmat e parë, dhe zbuloi yjet si: Charlie Chaplin, Harry Langdon, Feti Arbaki, Mejbli Normand, Ben Tarpin, Gloria Swanson, Kerol Lombard, Valas Biri, Meri Dresler, etj.. Ai gjithashtu siguroi kushtet për kryerjen e praktikës për disa nga regjisorët më të njohur të komedisë amerikane: Chaplin, Buster Keaton, por edhe Malkolm Sent Kler, Xhorxh Stivens, Roj Del Rut dhe Frenk Kapra. Përveç kësaj, popullariteti i madh ndërkombëtar i komedisë Keyston të Senettit i kontribuoi në mënyrë domethënëse dominimit komercial të Amerikës në filmin botëror në vitet e pas Luftës së Parë Botërore. Bindja e Senettit që filmi është mënyra e vetme e përshtatshme për humor vizual akrobatik vendosi zhanrin, i cili në vitet e '20-ta të shekullit XX do të bëhet mbase zhanri më i pëlqyeshëm dhe si i tillë me rëndësi të veçantë për historinë e filmit amerikan. Megjithatë, koncepti i tillë i Senettit për komedinë lidhet vetëm për filmin pa zë. Ky humor i pastër vizuel, do të humbas shumë, i ballafaquar me logjikën e gjuhës dhe të zhurmës natyrore, prandaj kur heshtja nuk ishte më komponentë esenciale e filmit, zhanri të cilit i ishte përkushtuar Senetti, u zhduk nga pëlhura e kinemasë. Senetti vazhdoi të xhirojë filma edhe pas kalimit të filmit në filmin me zë, por Keyston në vitin 1935 bankrottoi, ndërsa themeluesi i saj, nuk realizoi asnjë film tjetër deri në vdekjen e tij, në vitin 1960.

Charlie Chaplin(1889-1977)

Njeriu më i rëndësishëm dhe më me ndikim i Senettit ishte Charlie Chaplin (1889-1977). Chaplin i biri i muziktarëve të varfër britanik, e kishte kaluar jetën e tij në skenë. Si edhe në rastin e Charles Dickens dhe D.W. Griffith, me të cilët përngjan shumë, edhe

këndvështrimi i Chaplinit ndaj botës ishte i ngjyrosur me një rini të varfër, kështu që ai bashkëndjente thellë për të pafavorizuarit. Chaplin ishte interpretues dhe po merrte pjesë në një turne të një varieteteje në Amerikë, kur në vitin 1913, e angazhoi kompania Keystone Film, për 150 dollarë në javë. Në filmin e tij të parë të xhiruar për Senettin, (Making a Living, 1914)³, luan një dandy⁴ tipik anglez, ndërsa që në filmin e dytë ("Kid Auto Races at Venice"⁵, 1914) filloi ta ndërtojë rolin e një "endacaku të vogël" i cili do ta bëjë të njohur në botë dhe i cili do të bëhet një lloj simboli universal kinematografik i përbashkët për tërë njerëzimin. Chaplin realizoi 34 filma të shkurtër dhe një film të metrazhit të gjatë gjastë bobinësh (Tillie's Punctured Romance, Mack Senett, 1914), në studion Keyston, duke formësuar gradualisht karakterin e një klouni të vogël të pikëlluar, me këpucë të mëdha, pantollona të gjëra, dhe me setër e kapelë të vogël. Por, talenti i Chaplinit ishte i dedikuar për komedi të stilit më të ndjeshëm se sa ato të Keyston, prandaj në vitin 1914, ai nënshkruan një kontratë me kompaninë Essanay për xhirimin e 14 filmave të shkurtër dy bobinësh, në kundërvlerë të një shume të madhe prej 1250 dollarësh në javë. Këta filma, sikur edhe të gjithë filmat tjerë të ardhshëm, Chaplin do t' i realizojë vet në saje të përvojës së marrë në Keystone. Në fakt, në aspektin e teknikës narrative, Chaplin asnjëherë nuk u largua shumë nga ajo që e mësoi nga Senetti. Me një përjashtim të mundëshëm të filmit "Parisienja" (1923), filmat e tij nuk janë interesantë për formën, por për përmbajtjen – posaçërisht për karakterin brilant të endacakut të vogël i cili është plotësisht i ndryshëm nga bota përreth tij, e të cilin e realizon falë shkathtësisë së jashtëzakonshme të mimikës. Filmat më të njohur të Chaplinit nga kompania Essanay, janë: The Tramp, Work, Charles at bank⁶, dhe A night at the Show⁷ (të gjithë të realizuar në vitin 1915). Këta filma i dhanë popullaritet të jashtëzakonshëm, sa që vitin e ardhshëm munda të kërkonte pagën e një ylli – prej 10 mijë dollarësh në javë, si dhe një bonus prej 150 mijë dollarësh para nënshkrimit të kontratës për xhirimin e 12 filmave për kompaninë Mutual, nga të cilët më të njohurit janë: The Fireman⁸ (1916), The Pawnshop⁹ (1916), Polici¹⁰, The Adventurer¹¹ (1917), The Immigrant¹² (1917), etj. Këta filma dybobinësh ishin realizuar me kujdes të jashtëzakonshëm dhe paraqesin 12 kryevepra të pantomimës. Ata gjithashtu e bënë Chaplinin të popullarizuar në planin ndërkombëtar dhe për herë të parë shfaqën talentin e tij të shkëlqyer për satirën shoqërore- satirën e të varfërve për të pasurit, të dobtëve për të fortit, e cila e bëri të adhuruar te këta të parët, por jo edhe te shtresa

³<http://www.youtube.com/watch?v=ea0wupYVtIg>

⁴ xhentëlmen

⁵<http://www.youtube.com/watch?v=pQH0j2Ofgkq>

⁶<http://www.youtube.com/watch?v=ZPs-QKbkIPU>

⁷<http://www.youtube.com/watch?v=dBJG5ZOLUcl>

⁸http://www.youtube.com/watch?v=frOr5E_PG2U

⁹<http://www.youtube.com/watch?v=OFEaZSPiArA>

¹⁰<http://www.youtube.com/watch?v=au2QeCWGAng>

¹¹<http://www.youtube.com/watch?v=qZM3OKWKusg>

¹²<http://www.youtube.com/watch?v=GjzEdbVF4iM>

tjetër, e kjo sidomos në kohën e krizës së madhe ekonomike – Depresionit¹³, siç e kishin quajtur amerikanët. Për shembull, në filmin “Imigranti”, një nga sekuencat më të dukshme, ka të bëjë me raportet hipokrite të amerikanëve ndaj imigrantëve. Kur anija me të cilën Charlie arrin në ishullin Ellis, ai me shpresë dhe krenari shikon në Statujën e Lirisë. Pastaj paraqitet një mestitull në të cilin shkruan “Vendi i Lirisë”, dhe pas tij një kuadër me policinë e portit të Nju Jorkut të cilët i detyrojnë një numër të madh të familjeve imigrante, si tufa bagëtish, të presin për procedurat kufitare. Deri në vitin 1917, Chaplin bëhet një yll i jashtëzakonshëm, saqë kompania First National i ofroi një kontratë prej një milion dollarësh për realizimin e tetë filmave, pavarësisht gjatësisë. Kjo i mundësoi të themelonte studiot e veta, ku nga viti 1918 e më tej, i realizoi të gjithë filmat e tij, deri në vitin 1952, kur do ta braktisë vendin. Xhirues i tij në të gjitha këto prodhime ishte Roli Toterò (1891-1967), të cilin e kishte njohur në Essanay, në vitin 1915. Shumicën e filmave për First National e përbëjnë filmat e realizuar me zellshmëri në dy bobina, siç janë: A Dog’s Life¹⁴ (1918), Shoulder Arms¹⁵ (1918), Payday¹⁶ (1922), të cilët janë të ngjyrosur me kritikën shoqërore të cilën e kishte filluar në kompaninë Mutual. Por, filmi më i rëndësishëm i Chaplinit për First National ishte filmi i parë i metrazhit të gjatë të cilin e kishte xhiruar ai, The Kid¹⁷ (1921). Ky ishte një autobiografi komedi/dramë për kujdesin e endacakut (vagabondit) ndaj një fëmijenga kasollet e të varfërve, në të cilin patetika gërshetohet me humor të lehtë. Filmi u bë hit ndërkombëtar dhe u solli producentëve mbi 2,5 milionë dollarëpërfitime, vetëm në vitin e parë të shfaqjes së tij, duke e shndërruar në yll edhe aktorin e vogël Xheki Kugan. Filmi i fundit i Chaplinit i realizuar për First National, ishte filmi katërbobinësh “The Pilgrim”¹⁸ (1923), një satirë shoqërore në të cilin qytetarët e një vendi të vogël në Teksas, për një të dënuar të arratisur, gabimisht mendojnë se është prift, që sjell te situatat komike. Filmi është një fyerje brilante komike drejtuar hipokrizisë religjioze, dhe mbase pikërisht ky ka ndikuar në sulmet personale të cilat disa vite më vonë do t’i lansojnë grupacionet relegjioze kundër Chaplinit. Meqë i kishte përmbushur obligimet ndaj First National, Chaplini ishte i lirë që filmat e tij tani t’i shfaqte përmes United Artists. Filmi i tij i parë për këtë kompani ishte “Parisienja”¹⁹ (1923), një “dramë fati” e sofistikuar. Në këtë film Chaplini paraqitet shkurt. Ky film sikur edhe filmat e tjerë të xhiruar pas vitit 1923, janë filma të metrazhit të gjatë. Megjithatë, ai sërish në vitin 1925, do të paraqitet në filimin e tij të radhës, e popenë komike “The Gold Rush”, si figura qendrore e vagabondit të vogël. Ky film arrin të bëhet

¹³ Depresioni i Madh, filloi në tetor 1929 me kolapsin e Wall Street dhe shumë shpejt u përhap në gjithë botën. Ndryshimet në treg shënuan fillimet e një papunësie të lartë, përfitime të ulëta, varfëri, deflacion, ulje e të ardhurave në bujqësi...

¹⁴<http://www.youtube.com/watch?v=txSJDmt4u6Q>

¹⁵<http://www.youtube.com/watch?v=TxzEUtgCbNA>

¹⁶<http://www.youtube.com/watch?v=x77lmjd6nVw>

¹⁷<http://www.youtube.com/watch?v=sUvdSjDbvRA>

¹⁸<http://www.youtube.com/watch?v=ila4DXWcDQU>

¹⁹<http://www.youtube.com/watch?v=20pZujWcsjg>

komedi e fuqishme e përbërë nga fotografitë e jetës së rëndë, urisë dhe lakmisë, të cilat mbretërojnë derisa tre gërmues luftojnë për të drejtën e gjetjes së arit. Sipas ndjeshmërisë, pantomimës brilante dhe përzierjes së skenave tragjike e komike, ky film është vepra më karakteristike e Chaplinit. Ky ishte njëri ndër filmat më të dashur edhe të vet Chaplinit.

“The Circus”²⁰ (1928), është një film tjetër ku vagabondi përpiqet të bëhet kloun profesional. Është një film pa zë i realizuar shkëlqyeshëm i cili filloi të shfaqej njëkohësisht me fillimin e kalimit në filmin me zë. Për këtë film, Chaplinit i ishte ndarë shpërblimi special në ceremoninë e ndarjes së Çmimeve të Akademisë 1929, për “gjithanshmërinë dhe gjenialitetin e të shkruarit, aktrimit, regjisë dhe produksionit”. Gjatë xhirimeve të filmit “The Circus”, Chaplini po kalonte një fazë të vështirë të divorcimit me gruan e tij të dytë, prandaj edhe ishte bërë cak i një kampanje kundër tij, të cilën e udhëhiqnin grupe religjioze dhe “moraliste”, gjë që e shtyu gati në vetëvrasje. Një karakteristikë tjetër e Chaplinit është se dy filmat e tij të parë me zë janë prodhuar me muzikë (të cilën e kishte shkruar vet ai) dhe me efekte zanore por me shumë pak dialog, kjo ishte mënyra e tij e shpërndarjes së artit të pantomimës edhe në kohën e filmit me zë. “City Lights” (1931) është një film sentimental, me plot efekte, në të cilin një endacak i papunë dashurohet në shitësen e verbër të luleve dhe kalon nëpër një seri telashesh, duke përfshirë edhe grabitjen, në përpjekje për të mbledhë paratë e nevojshme për operacionin i cili do t’ia kthente shikimin. Chaplin këtë film e ka quajtur “komedi e romancës dhe pantomimës”, çfarë edhe është, por gjithashtu edhe vepër e heshtur e kritikës shoqërore të cilën çështja e të varfërve është e mbrojtur nga të pasurit. Sikur të kishte ekzistuar sadopak dyshim në aspektin e natyrës së bindjeve sociale të Chaplinit, edhe ai pak dyshim do të shpërndahej me veprën “Modern Times” (1936), filmin për johumanizmin e punëtorit të thjeshtë në botë, i cili përmes makinave, i shërben të pasurve. Në këtë film Chaplin luan një punëtor fabrike të cilin e përjashtojnë nga puna, pasi që ka përjetuar goditje nervore (por komike) në shiritin lëvizës, por i cili pas kësaj i ndërron disa punë të ndryshme dhe përfundon si i papunësuar, por i pamposhtur. Kjo satirë filmike e industrializimit dhe pabarazisë në “kohërat moderne” të Depresionit të madh, i solli pak popullaritet midis të fuqishmëve në ShBA. Ai u quajt “propaganda e kuqe”, ndërsa në Gjermani dhe Itali ky film ishte ndaluar fare të shfaqej. Por, në pjesën tjetër të Evropës filmi “Kohërat moderne” arriti shumë sukses, prandaj edhe në ditët e sotme mbetet njëri ndër filmat më qesharak të Chaplinit, një ndër veprat më të strukturuar dhe me më së shumti angazhim shoqëror.

Në filmin “The Great Dictator” (1940), Chaplini realizoi filmin e tij të parë me zë dhe njërin ndër filmat e parë holivudian anti-nazist. Filmi është një satirë drejtuar diktatorëve evropianë, filmi është një kronikë e sundimit të Adenoid Henkel, diktatori i Tomanisë, i cili persektuon hebrenjtë dhe e shtyn Evropën në një luftë tjetër. Chaplini në këtë film luan dy role, Hinkelin dhe berberin hebre. Këtë film kritika nuk e pranoi shumë mirë:

²⁰<http://www.youtube.com/watch?v=2CySSvc1Kdk>

shumë prej kritikëve mendonin që porosia e tij politike ishte shumë serioze, ndërsa disa të tjerë konsideronin se nuk është njaftueshëm serioze. Sidoqoftë, “Diktatori i madh”, ishte një hit komercial, falë statusit të yllit të autorit të tij të popullarizuar. Gjatë luftës, megjithatë, Chaplin kishte mbajtur një seri të fjalimeve të hapura politike, në të cilat e mbështeste Bashkimin Sovjetik, gjë që e bëri kandidatin e parë për “listën e zezë” pas luftës. Dhe, aq më keq, ishte i përfshirë në njërin nga paditë më të zakonshme për vërtetimin e atësisë, të cilën e kishte inicuar partnerja e tij e afërt Xhoan Bari, dhe në vitin 1944 i ishte drejtuar Gjykatës Federale për shkak të shkeljes së Ligjit Mann (Mann Act)²¹. Jo pa arsye, filmi i radhës i Chaplinit ishte një realizim cinik, i ashtuquajtur “komedi vrasare”, që titullohej “Monsieur Verdoux” (1947) i bazuar në krimet e vrasësit masiv, famëkeqit francez Landru, për të cilin film idenë ia kishte dhënë Orson Wels. Në këtë film zyrtari bankar nga Parisi (Chaplin) e humb punën dhe fillon të martohet me gra të pasura, të cilat pastaj i vret dhe siguron para për të mbajtur gruan e tij invalide dhe fëmijën e tyre.

Filmi në ShBA ishte larguar nga repertori, gjashtë javë pas premierës, ndërsa në Francë, kishte arritur sukses dhe shikueshmëri të madhe. Marrëdhënia e Chaplinit me publikun amerikan po ftohej gjithnjë, e sidomos pasi nga filmat e tij ishte larguar endacaku i vogël dhe në vend të tij po vinte një kritikues i sistemit shoqëror.

Filmi i fundit amerikan i Chaplinit ishte “Dritat e teatrit” (1952), në të cilin Chaplin trajton sallat muzikore nga fëmijëria e tij në Londër, për të rryer një tregim për një muzikant të vjetër londinez.

Filmi i fundit i Chaplinit, është “The Countess from Hong Kong”²² 1966, (Kontesha nga Hong Kongu), në të cilin paraqiten Marlon Brando dhe Sofia Loren në rolet kryesore.

Buster Keaton

Është e rëndësishme të krahasohet filmi i Charlie Chaplin-it, në esencë teatral, me filmin e kolegut të tij, krijuesit filmik dhe gjenit të komedisë, Buster Keaton (1895 – 1966). Sikur Chaplini, edhe Keaton-i u rrit varieteve me prindërit e tij; për herë të parë u paraqit në skenë bashkë me ta kur ishte tre vjeç. Qysh në rininë e hershme u angazhua në zgjidhjen e problemeve komplekse të mizanskenës për shfaqjen e tyre familjare, prandaj rrënjët e talentit të mëvonshëm regjisorial të tij, duhet të shihen te këto përvoja të para. Edhe pse famën e tij për njëzet vjet e errësoi Chaplin, sot është e qartë se ai ishte aktor i shkallës së njëjtë me Chaplinin dhe regjisor më i mirë se ai.

Kur shfaqja familjare dështoi në vitin 1917, ai ishte 21 vjeçar dhe tashmë yll. Atij iu ofrua një kontratë për të marrë pjesë në shoune popullarizuar të Shubertit, “Passing show”,

²¹ Ligji Mann, i aprovuar në Kongresin e ShBA në qershor 1910, për ndalimin e transportit ndërkombëtar të femrave për qëllime jomorale, siç janë malli i bardhë, prostitucioni, etj.

²² <http://www.youtube.com/watch?v=gMXItkSH3Q>

1917; por ai në vend të kësaj vendosi të angazhohej si aktor në role dytësore në Comique Film Corporation (Korpratën Komike të Filmit) të Jozef Shenkut, të themeluar në pranverën e vitit 1917, dhe bën produksionin e filmave të Rosko Feti Arbakelit, të cilat do të shfaqeshin përmes kompanisë Paramount.

Aty Keaton xhiroj pesëmbëdhjetë filmatë shkurtër me nga dy role, bashkë me Arbaklin – prej filmit “Buthcher Boy” i vitit 1917 deri te filmi “Garage” i vitit 1919 – në të cilët kualiteti dhe finesa e prodhimit të studiove është dukshëm më i mirë, ashtu edhe sa i përket formës dhe përmbajtjes.

Në fund të vitit 1919, Shenk themeloi kompaninë Baster Kition Production, për prodhimin e filmave të shkurtër komik me Kitionin në rolin kryesor. Për këta filma ai huazoi ish studiot e Chaplinit. Shenk udhëhiqte me të gjitha punët financiare, por Kitionit i dha liri të plotë krijuese për të shkruar e bërë regji, me një rrogë prej njëmijë dollarësh në javë, plus 25 % nga fitimi i realizuar. Rezultati ishte nëntëmbëdhjetë filma të shkurtër të xhiruar ndërmjet viteve 1920-1923, të shfaqura nga kompania Metro dhe First National, e të cilat bashkë me filmat e Chaplinit të kompanisë Mutual, përfaqësojnë arritjen më të madhe të komedisë amerikane Slapstick.

Filmat më të mirë nga ata janë: “Gjashtëshja” (1920), “Bricjapi” (1921), “Teatri” (1921), “Anija” (1921), “Policët” (1922) dhe “I çmendur pas topit” (1923). Ndërlidhja e strukturës dhe shija e stërholluar për pamje (vizualitet) i bën këta filma të veçantë ndaj filmave të tjerë Slapstick. Kition gjithnjë konsideronte se komedia duhej të ishte qesharake dhe jo e denjë për t’u tallur, dhe për këtë ai investoi shumë mund qetë siguronte besueshmërinë e filmave të tij edhe në kuptimin komik dhe dramaturgjik. Për dallim nga Senetti dhe shumë imituesë të tij të tjerë, pjesa më e madhe e përfeksionizmit të Kitionit, si krijues filmik buron nga respektimi i rreptë i logjikës së dramës në filmat e tij artistik, dhe prania e gegut (shakasë) të cilat rriten me progresivitet gjeometrik sipas modelit të bazuar në personazhedhe në vetë rrëfimin. Filmi i parë i metrazhit të gjatë i Kitionit, “The Saphead” ishte me shtatë role, me regji të Herbert Blashe (1882-1953), i xhiruar në vitin 1920 për Metro. Ky film, adaptim i një komedietë vitit 1887, për familjen e një komisioneri nga Uollstriti, ishte i rëndësishëm për zhvillimin e Keaton-it, pasi ishte mundësia e parë të realizojë karakterizimin e vazhdueshëm dramatik të personazhit në film. Deri në vitin 1923 prodhimi i filmave dy bobinësh sillte gjithnjë më pak përfitim, për shkak të interesimit të publikut për filma të metrazhit të gjatë. Prandaj Shenk, ndyshoi planin e produksionit, të studiove të Kitionit, kështu që në vend të tetë filmave të metrazhit të shkurtër, xhiroj dy filma të pavarur të metrazhit të gjatë në vit, të cilët do të distribuoheshin nga Metro / MGM, por te të cilët autorët e filmit do të mbanin kontrollin artistik. Paga e Kitionit ngrit në nivelin e yllit (dy mijë pesëqind dollarë në javë plus 25 për qind të fitimeve), dhe kështu filloi një periudhë emajës së krijimtarisë së tij. Është thënë se pas vitit 1923, Kition ishte i rëndësishëm sa cilidoregjisor tjetër i Hollywoodit, ndërsa si personalitet ishte aq kreativ, sa që identifikohet edhe në filmat të cilët në siglën hyrëse nuk e mbajnë emrin e tij së regjisor. Filmi i tij i parë i pavarur i Keaton Productions, “Tri epokat” (1923), është një imitim i keq i filmittë

Griffith "Mosdurimi", regjinë e të cilit Kiton e bëri nëbashkëpunim me Eddie Klein (1892-1961) kushpalos mënyrat e vardisjes në triperiudha të ndryshme historike: Epoka e Gurit, Romësë lashtë dhe Amerikës Moderne. Edhe pse mizanskenanuk është aq e zhvilluar, dhe as rrëfimi i tij nuk është aq mirë i integruar, si në filmat e tij të mëparshëm, filmi "Tri epokat", është një komedi esukseshme, kute përbërësi final është futur arma klasikee Kitonit – "dramaturgjia e gegut, ku në një tajming të përkryertë akrtimit, regjisë së montazhës, e shtyen personazhin e Kitonit në një seri të gjatë dramatike të lidhur me gegun vizuel, e cila përfundon me ndërthurjen e sekuencave apo tërë filmit. Në fund të sekuencës së kohës moderne, te filmi "Tri epokat", Kiton, psh. në planin e përgjithshëm kërcen nga dalja në rast zjarri nga gjashtë katëshi te ndërtesa fqinje.

Kitoni sikur edhe Chaplini ishte aktor shumë i ndjeshëm. "Fytyra e tij e gurtë" mund të shkaktonte shpërthim të madh emocional, ndërsa ai ishte në gjendje të shprehte gjithçka përmes trupit. Sikur edhe Chaplini, Kiton e dinte se komedia e madhe gjithmonë ishte buzë tragjedisë, por ndjeshmëria nuk kishte domethënie të madhe në veprat e Kitonit. Për të dy artistët, komedia ishte një përzierje e çuditshme e logjikës dhe fantazisë, në të cilën e pamundura bëhet e mundur.

Slapstick komedia

Kur flasim për slapstick komedinë atëherë mendojmë në përkthimin fjalë për fjalë të kësaj shprehjeje, që nënkupton goditje me shkop. Mendohet në një shkop elastik me ndihmën e të cilit krijohet "zhurmë maksimale dhe dhimbje minimale". Ky emërtim ka rrjedhur nga marrëdhënia tallëse dhe nënvlerësuese ndaj këtij lloji të komedisë e cila bazohet në gegun fizik në të cilin merr pjesë tërë trupi i njeriut. Prandaj komikët e atëhershëm ishin edhe akrobatë shumë të shkathët. Më vonë ky nocion do të përdorej si sinonim për tërë burleskën pa zë amerikane.

Për shkak të karakteristikave të saj, slapstick ishte zhanër ideal në kohën e filmit pa zë sepse në qendër të ngjarjes ishte humori që nuk mbështetej në spiritualitetin verbal apo dialog por në vet gegun fizik.

Edhe pse në fillim emërtimi slapstick në njëfarë mënyre ishte përçmues, me kalimin e kohës ky emërtim u bë i njohur si emërtim i rregullt për të cilin askush tani më nuk e kishte në mendje kuptimin figurativ, por u shndërrua në zhanrin më të pëqyer në të cilin disa komikë të asaj kohe krijuan kryevepra.

Paraardhës i këtij zhanri ishte komiku francez Max Linder, të cilin edhe vet Charlie Chaplin e konsideronte si mësuesin më të madh të tij.